



# POLITIKA MES DIPLOMACISË

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2024



AUTOR  
LORELA ALIA



## PËRMBAJTJA

1.	HYRJE .....	3
	Objekti i Studimit .....	3
2.	METODOLOGJIA .....	4
3.	LEGJISLACIONI MBI POLITIKËN E JASHTME DHE MANGËSITË E TIJ .	4
4.	ANALIZA E TË DHËNAVE: VLERËSIM DHE INTERPRETIM .....	11
5.	NDRYSHIMET LIGJORE TË REJA: KONTEKSTI DHE PASOJAT .....	14
6.	GJETJET KRYESORE .....	16
7.	REKOMANDIME .....	17
8.	REFERENCA .....	18



## 1. HYRJE

Diplomacia shqiptare është një ndër shtyllat kryesore të përfaqësimit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Ligji për shërbimin e jashtëm, Nr. 23/2015, përcakton rregullat dhe procedurat për emërimin, qëndrimin dhe funksionimin e përfaqësuesve shqiptarë në postet diplomatike. Sidoqoftë, zbatimi i këtij ligji ka qenë problematik, duke u shoqëruar me një sërë shkeljesh që kanë dëmtuar imazhin dhe efikasitetin e diplomacisë shqiptare. Ky raport trajton çështjet kryesore që lidhen me tejkalimin e mandateve diplomatike, përfshirjen e individëve pa status diplomatik, dhe ndërhyrjen e politikës në emërimet diplomatike.

### Objektivi i Studimit

Ky studim ka për synim të analizojë figurat e 54 ambasadorëve dhe konsujve të Shqipërisë në botë, duke u fokusuar në përmbushjen e mandateve të tyre ligjore dhe aspektet e lidhura me karrierën e tyre diplomatike, duke përfshirë:

#### 1- Viti i Marrjes së Detyrës:

Do të analizojmë nëse ambasadorët dhe konsujt kanë tejkaluar mandatin 3-vjeçar të përcaktuar nga Ligji për Politikën e Jashtme. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e praktikave të zakonshme dhe në vlerësimin e stabilitetit në pozitë të tyre diplomatike.

#### 2- Karriera Politike:

Kjo pjesë e studimit do të shqyrtojë ndikimet e drejtpërdrejta politike në përzgjedhjen dhe funksionimin e ambasadorëve. Karriera politike nënkupton angazhimin e individëve në veprimtaritë dhe postet brenda institucioneve qeveritare ose partive politike. Do të analizohen pozitë të ambasadorëve nëqë kanë pasur:

Poste të Larta Qeveritare: si Ministër, Zëvendësministër, Kryetar bashkie, Këshilltarë të Kryeministrit, Ministrave dhe Kryetarve të bashkisë

Poste në Parti Politike: Analiza do të përfshijë ata që kanë qenë Kryetarë ose anëtarë të kryesisë së partive politike.

Deputetë: Ata që kanë shërbyer si anëtarë të Parlamentit të një partie politike të caktuar ose si kandidatë për deputetë.



### 3- Statusi Diplomatik:

Do të vlerësojmë nëse individët kanë statusin formal të diplomatëve sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin 23/2015 për Politikën e Jashtme. Kjo do të ndihmojë në kuptimin e legjitimitetit dhe funksionit të tyre në arenën ndërkombëtare.

## 2. METODOLOGJIA

Do të përdoret një metodë sasiore dhe cilësore e analizës së të dhënave, për të realizuar një analizë të detajuar për secilën nga 54 figurat diplomatike, e cila bazohet në burime dokumentare dhe analiza dytësore të prodhimeve shkencore e raporteve. Burimet kryesore përfshijnë:

Ligji 23/2015 për Politikën e Jashtme – për të identifikuar kërkesat ligjore për mandatet e ambasadorëve dhe konsujve.

Burimet institucionale dhe qeveritare – raporte nga MEPJ dhe institucione të tjera relevante për të marrë informacion mbi vitin e marrjes së detyrës dhe statusin diplomatic

Ky studim do të ofrojë një pasqyrë të gjendjes aktuale të përfaqësimit diplomatik të Shqipërisë.

## 3. LEGJISLACIONI MBI POLITIKËN E JASHTME DHE MANGËSITË E TIJ

Diplomacia, si një nga elementët kryesorë të politikës së jashtme të një vendi, është jetike për mbrojtjen e interesave kombëtare dhe përfaqësimin e denjë në arenën ndërkombëtare. Shqipëria, si një vend i vogël me ambicie europiane dhe globale, duhet të ketë një shërbim të jashtëm profesional.

**Ligji nr. 23/2015** përcakton se diplomatët e nivelit të lartë, përfshirë ambasadorët dhe konsujt, duhet të kenë një mandat **trevjeçar**. **Neni 26, pika 5** specifikon se *funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, për një periudhë trevjeçare*. Ky ligj përcakton gjithashtu kërkesat për përzgjedhjen e ambasadorëve apo diplomatëve, duke përfshirë përvojën në fushën e





marrëdhënieve ndërkombëtare, shkencave politike apo të drejtës ndërkombëtare.<sup>1</sup>

Sipas **Neni 27, pika 1**, kreu i misionit diplomatik përzgjidhet ndërmjet diplomatëve të karrierës me gradë të lartë, jo më pak se këshilltar. Përfaqësuesit diplomatikë duhet gjithashtu të kenë të paktën **10 vite përvojë** në politikën e jashtme, marrëdhëniet ndërkombëtare, marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare ose të drejtën ndërkombëtare, (**Neni 27, pika 2**)

Shkelja e **Ligjit nr. 23/2015** : një problem i vazhdueshëm

Ligji i vitit 2015 parashikon që mandati i ambasadorëve shqiptarë është trevjeçar, dhe përmban një mungesë qartësie mbi mundësinë e rinovimit të tij. Kjo hapësirë e paqartë në ligj është shfrytëzuar nga drejtuesit e misioneve diplomatike, të cilët, në shumë raste, kanë qëndruar në të njëjtat pozicione për periudha që tejkalojnë çdo kufizim të ligjit. Në disa raste, ambasadorët kanë shërbyer deri në dhjetë vite apo më shumë,<sup>2</sup> pa respektuar rotacionin e parashikuar. Ky fenomen përbën një shkelje të qartë të ligjit dhe është kritikuar nga aktorë të ndryshëm të diplomacisë, si dhe ish-ambasadorë të cilët theksojnë se një qëndrueshmëri e tillë dëmton neutralitetin dhe profesionalizmin e ambasadorëve.<sup>3</sup> Zgjatja e mandateve jo vetëm që krijon një imazh negativ për Shqipërinë, por rrezikon edhe vetë efektivitetin e misioneve diplomatike.

Një tjetër aspekt shqetësues është se disa ambasadorë nuk kalojnë nga një pozicion në tjetër përmes meritokracisë, por përmes rotacioneve të ndërhyrjeve politike. Ata qëndrojnë në diplomaci, jo sepse kanë dhënë rezultate të shkëlqyera, por sepse janë përzgjedhur për të kënaqur interesat politike të qeverisë. Kjo krijon një rreth vicioz ku diplomatët nuk i shërbejnë vendit, por partive politike.

Një problem tjetër thelbësor lidhet me emërimin e personave pa përvojë të mjaftueshme në shërbimin diplomatik, si ambasadorë apo konsuj. Neni 27<sup>4</sup> i ligjit për shërbimin e jashtëm përcakton qartë se për të qenë ambasador, një individ duhet të ketë të paktën dhjetë vite përvojë në fushën e



<sup>1</sup> Qeveria e Shqipërisë. (2015). *Ligji Nr. 23/2015 për shërbimin e jashtëm*. Tiranë

<sup>2</sup> Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. (n.d.). *Përfaqësuesit shqiptarë në botë*.

<sup>3</sup> Liberale. (2024, 5 tetor). *Ambasadorë me mandat 10-vjeçar: Shqipëria, një rast unik në botë*. 41 titullarë të përfaqësive tona në shkelje të ligjit. Liberale.

<sup>4</sup> Qeveria e Shqipërisë. (2015). *Ligji Nr. 23/2015 për shërbimin e jashtëm*. Tiranë

marrëdhëniet ndërkombëtare, të drejtës ndërkombëtare, apo politikës së jashtme, ndër të cilat tre vite në pozicione drejtuese. Megjithatë, shpesh këto kritere nuk janë përmbushur. Një numër i konsiderueshëm ambasadorësh janë emëruar nga jashtë sistemit diplomatik, pa ndonjë përvojë relevante në këtë fushë. Kjo sjellje jo vetëm që shkel ligjin, por zbeh edhe cilësinë e përfaqësimit ndërkombëtar të Shqipërisë. Pa përvojë dhe ekspertizë të duhur, këta diplomatë dëmtojnë imazhin e vendit dhe shpesh dështojnë të përballen me sfidat komplekse të diplomacisë moderne.

Për më tepër, politizimi i rekrutimeve në diplomaci ka bërë që shumë individë të pa kualifikuar të zënë poste të rëndësishme, duke lënë jashtë profesionistë të kualifikuar që kanë investuar vite të tëra në ndërtimin e një karriere diplomatike.<sup>5</sup> Kjo përforcon një kulturë të nepotizmit dhe lidhjeve partiake, duke lënë mënjanë meritokracinë, e cila duhet të jetë shtylla kryesore e shërbimit të jashtëm.

Një nga ndryshimet më të rëndësishme që ligji i vitit 2015<sup>6</sup> solli ishte reduktimi i kompetencave të Presidentit dhe Komisionit të Politikës së Jashtme në procesin e emërimit dhe shkarkimit të ambasadorëve. Këto institucione, të cilat tradicionalisht kishin një rol të rëndësishëm në garantimin e një procesi transparent dhe të drejtë, tashmë kanë një rol më shumë degjues, duke i dhënë Kryeministrit dhe qeverisë një pushtet të tepruar në emërimet diplomatike. Kjo ka krijuar një hapësirë për abuzime dhe manipulime politike, ku ambasadorët emërohen jo për shkak të aftësive të tyre profesionale, por për shkak të afërsisë me pushtetin politik.

Ky transferim i kompetencave ka dobësuar rolin e institucioneve të pavarura dhe ka krijuar një diplomaci të centralizuar, të varur nga vendimet e Kryeministrit. Një rikthim i kompetencave të mëparshme Kuvendit dhe Presidentit do të ishte një hap drejt përmirësimit të procesit të emërimit të diplomatëve dhe do të siguronte një proces më të drejtë dhe të bazuar në meritokraci.

## TË DHËNAT MBI DIPLOMACINË SHQIPTARE: NJË PASQYRË E SITUATËS AKTUALE

Tabela e mëposhtme me të dhënat e krerëve të përfaqësive shqiptare ka për qëllim të shqyrtojë profilet e 54 ambasadorëve dhe konsujve shqiptarë në

---

<sup>5</sup> Tabela 1

<sup>6</sup> Ibid.



përfaqësitë ndërkombëtare, duke u përqendruar në disa aspekte kryesore të karrierës së tyre diplomatike. Analiza përfshin:

Koha e marrjes së detyrës – për të vlerësuar nëse diplomatët kanë respektuar kufirin ligjor të mandatit 3-vjeçar apo e kanë tejkaluar atë.

Karriera politike – për të kuptuar nëse zgjedhja dhe veprimet e tyre janë ndikuar nga afërsitë politike.

Statusi diplomatik – për të analizuar nëse përfaqësuesit përmbushin kriteret formale të statusit diplomatik, sipas Ligjit Nr. 23/2015 për Politikën e Jashtme.

Tabela 1

Nr. <sup>7</sup>	Shteti/ Institucioni	Ambasada/ Misioni/ Konsullata	Ambasador / Konsull	Viti i marrjes së detyrës	Karrierë politike	Statusi Diplomat	Mandati përfunduar
1	Arabia Saudite	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Saimir Bala	2021	Jo	Diplomat	Jo
2	Austri	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Fatmir Velaj <sup>8</sup>	2023	Po	Pa status	Jo
3	Australi	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ardian Mara (I Ngarkuar me Punë a.i)	2021	Jo	Diplomat	Jo
4	Belgjikë	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ferit Hoxha <sup>9</sup>	2024	Jo	Diplomat	Po
5	Brazil	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Rezar Bregu	2018	Jo	Diplomat	Po
6	Bullgari	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Inid Milo	2023	Jo	Diplomat	Jo
7	Danimarkë	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Sokol Dedja	2024	Jo	Diplomat	Jo
8	Egjipt	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Sami Shiba <sup>10</sup>	2024	Jo	Diplomat	Po

<sup>7</sup> Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. (n.d.). *Përfaqësitë shqiptare në botë*.

<https://punetejashtme.gov.al/perfaqesite-shqiptare-ne-bote/>

<sup>8</sup> 2017-2021 Deputet i PS- së në Parlamentin e RSH-së

<sup>9</sup> 2018-aktualisht deri në tetor 2021 Ambasador dhe Delegat i Përherëshëm i Shqipërisë në UNESCO

2021- 2024 Ambasadore në OKB

2024 Ambasadore pranë misionit të Shqipërisë në BE.

<sup>10</sup> 2011 – 2014 Ambasadore në Rumani

2015 – 2024 Ambasador në Mbretërinë e Arabisë Saudite.





9	Emiratet e Bashkuara Arabe	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ridi Kurtezi	2023	Jo	Diplomat	Jo
10	Francë	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Dritan Tola	2013	Jo	Diplomat	Po
11	Greqi	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Lueta Hajdaraga	2020	Jo	Diplomat	Po
12	Gjermani	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Adia Sakiqi <sup>11</sup>	2023	Jo	Diplomat	Po
13	Holandë	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Artur Kuko <sup>12</sup>	2023	Jo	Diplomat	Po
14	Hungari	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ilirian Kuka <sup>13</sup>	2023	Jo	Pa status	Po
15	Itali	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Anila Bitri	2016	Jo	Diplomat	Po
16	Izrael	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Meri Kumbe <sup>14</sup>	2023	Po	Pa status	Jo
17	Japoni	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ermal Muça <sup>15</sup>	2024	Jo	Diplomat	Po
18	Kanada	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Artemis Malo <sup>16</sup>	2021	Po		Jo
19	Katar	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Nuri Domi (I Ngarkuar me Punë a.i)	2021	Jo	Diplomat	Jo
20	Kosovë	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Petrit Malaj <sup>17</sup>	2018	Po	Pa status	Jo

2024 Ambasador në Republikën Arabe të Egjiptit.

<sup>11</sup> 2014-2023 Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Holandës

<sup>12</sup> 2002 – 2007, Ambasador, Shef i Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Ambasador në Mbretërinë e Belgjikës.

2007 – 2009, Ambasador, Shef i Misionit të Republikës së Shqipërisë në NATO;

2009 – 2014, Ambasador, Përfaqësues i Përhershëm i Shqipërisë në Këshillin e Atlantikut të Veriut, NATO;

2014 – 2023, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën Federale të Gjermanisë;

2023 - aktualisht, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Holandës;

<sup>13</sup> 2018-2023, Ambasador në Republikën Çeke.

2023 – aktualisht, Ambasador në Hungari

<sup>14</sup> 2022-2023 zv.Ministre e Kulturës.

<sup>15</sup> 2016 – 2024, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kanada.

2024 – aktualisht, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Japoni.

<sup>16</sup> 2017-2019 Zv.ministre e Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

2019-2021 Deputete e PS-së në Parlamentin e RSH-së.

2022-2024 Zv.ministre e Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

<sup>17</sup> 2021 Kandidatë për deputet i PS-së.





21	Kroaci	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Riza Poda <sup>18</sup>	2018	Jo	Diplomat	Po
22	Kuvajjt	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ilir Hysa	2023	Jo	Diplomat	Jo
23	Mali i Zi	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Zhaklina Peto	2023	Jo	Pa status	Jo
24	Maqedonia e Veriut	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Denion Meidani <sup>19</sup>	2023	Po	Pa status	Jo
25	Mbretëria e Bashkuar	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Uran Ferizi	2023	Jo	Pa status	Jo
26	Poloni	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Mimoza Halimi	2024	Jo	Diplomat	Jo
27	Republika Çeke	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ilir Tepelena <sup>20</sup>	2023	Jo	Diplomat	Po
28	Republika Popullore e Kinës	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Selim Belortaja <sup>21</sup>	2017	Po	Pa status	Po
29	Rumani	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Enkeleda Mërkuri <sup>22</sup>	2024	Jo	Diplomat	Po
30	Rusi	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Genc Pecani	2023	Jo	Diplomat	Jo
31	Serbi	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Bardhyl Canqj <sup>23</sup>	2023	Jo	Diplomat	Po
32	Slovaki	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Arten Hanku	2023	Jo	Diplomat	Jo
33	Sloveni	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Oljan Kanushi <sup>24</sup>	2024	Po	Pa status	Jo



<sup>18</sup> 2018 –aktualisht, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kroacisë 2014-2018, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën Çeke.

<sup>19</sup>Ish-Këshilltar në MEPJ.

Drejtor i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Ekonomisë.

<sup>20</sup> 2023 –aktualisht, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën Çeke;

2015 – 2023 – Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Rumani;

2010 – 2014 – Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës - Bruksel;

<sup>21</sup> 2009-2013 Zv.ministrë i Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

<sup>22</sup> 2024 – aktualisht, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Rumani.

2016 – 2024, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Republikën Sllovaqe;

<sup>23</sup> 2023- Aktualisht Ambasador në Republikën e Serbisë

2015-2023 Ambasador në Izrael .

<sup>24</sup> Ish-Këshilltar i Kryeministrit Rama për biznesin.

34	Spanjë	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Entela Gjika	2023	Jo	Diplomat	Jo
35	Suedi	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Albana Dautllari	2024	Jo	Diplomat	Jo
36	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Ervin Bushati <sup>25</sup>	2023	Po	Pa status	Jo
37	Turqi	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Blerta Kadzadej <sup>26</sup>	2023	Jo		Po
38	Vatikan	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Majlinda Frangaj	2023	Jo	Pa status	Jo
39	Zvicër	Ambasada e Republikës së Shqipërisë	Mustafa Nano	2023	Jo	Pa status	Jo
40	Bashkimi Evropian	Misioni pranë BE-së	Ferit Hoxha	2023	Jo	Diplomat	Po
41	Këshilli i Evropës	Misioni pranë Këshillit të Evropës	Dastid Koreshi	2021	Jo	Diplomat	Jo
42	NATO	Përfaqësia pranë NATO-s	Ilir Gjoni <sup>27</sup>	2023	Po	Pa status	Po
43	OKB	Misioni pranë OKB-së në Nju Jork	Suela Janina <sup>28</sup>	2023	Jo	Diplomat	Po
44	Gjenevë	Misioni pranë Zyrës së OKB-së në Gjenevë	Vasilika Hysi <sup>29</sup>	2022	Po	Pa status	Jo
45	UNESCO	Misioni pranë UNESCO-s	Besiana Kadare	2017	Jo	Diplomat	Jo
46	UNOV/OSBE	Misioni pranë Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë	Eglantina Gjermeni <sup>30</sup>	2022	Po	Pa status	Jo
47	Bari	Konsullata e Përgjithshme	Arjan Vasjari	2022	Jo	Pa status	Jo

<sup>25</sup> 2014-2021 Deputet i PS-së

<sup>26</sup> 2019-2023 Konsullja e Përgjithshme e Shqipërisë në Stamboll. 2023 – Aktualisht Ambasadore e RSH-së në Republikën e Turqisë

<sup>27</sup> 2023 -aktualisht, Ambasador, Përfaqësues i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në NATO. 2014-2023, Ambasador i RSH-se në Zvicër.

<sup>28</sup> 2023- aktualisht, Ambasadore ne Misionin e Përhershëm te Republikës së Shqipërisë në OKB në Nju Jork 2014-2023, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë pranë BE-se.

<sup>29</sup>2009-2021 Deputete e PS-së në Parlamentin e RSH-së

2017-2021 nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

<sup>30</sup> 2009-2017 Deputete e PS-së në Parlamentin e RSH-së

2013-2017 Ministre e Zhvillimit Urban.





48	Milano	Konsullata e Përgjithshme	Anila Pojani	2016	Jo	Pa status	Po
49	Janinë	Konsullata e Përgjithshme	Irida Laçi	2023	Jo	Diplomat	Jo
50	Selanik	Konsullata e Përgjithshme	Erida Dobrush	2024	Jo	Diplomat	Jo
51	Mynih	Konsullata e Përgjithshme	Gentiana Mburimi	2023	Jo	Diplomat	Jo
52	Stamboll	Konsullata e Përgjithshme	Armand Shandro	2023	Jo	Diplomat	Jo
53	Strugë	Konsullata e Përgjithshme	Petrit Musaj	20223	Jo	Diplomat	Jo
54	Azerbajxhan	Në pritje të hapjes së Ambasadës	Besart Kadia <sup>31</sup>	2024	Po	Pa status	Jo

Tabela 2

Kategoria	Numri	Përqindja
<b>Numri total i ambasadave/konsullatave/misioneve</b>	54	100%
<b>Ambasador/Konsuj që kanë përfunduar mandatin</b>	20	37 %
<b>Ambasador/Konsuj me karrierë politik</b>	12	22.2%
<b>Ambasador/Konsuj pa status diplomatik</b>	18	33.3%

## 4. ANALIZA E TË DHËNAVE: VLERËSIM DHE INTERPRETIM

Këto të dhëna ofrojnë një pamje të qartë mbi statusin dhe karakteristikat e ambasadorëve dhe konsujve shqiptarë, të ndarë në kategori të ndryshme. Ato përfshijnë numrin total të ambasadave, përfundimet e mandateve, karriera politike, si dhe statusin diplomatik të përfaqësuesve. Shqipëria ka një total prej 54 ambasadash, konsullatash dhe misionesh. Ky

<sup>31</sup> Shqiptarja.com. (2024). Besart Kadia emërohet ambasador në Azerbajxhan, Tonin Gjurarj në Kroaci, Artemis Malo në Kanada. <https://shqiptarja.com/lajm/besart-kadia-emerohet-ambasador-ne-azerbajxhan-tonin-gjuraj-ne-kroaci-artemis-malo-ne-kanada>



numër pasqyron angazhimin e Shqipërisë në diplomacinë ndërkombëtare dhe përpjekjet për të përmirësuar marrëdhëniet me vendet e tjera. Një numër i lartë i ambasadave dhe konsullatave tregon një strategji aktive për të ndihmuar në promovimin e interesave kombëtare dhe për të ofruar mbështetje për qytetarët shqiptarë jashtë vendit.

### **Ambasadorë/Konsuj që Kanë Përfunduar Mandatin**

Një numër prej 20 ambasadorësh dhe konsujsh (37%)<sup>32</sup> kanë përfunduar mandatin e tyre trevjeçar, siç përcaktohet në ligjin shqiptar për politikën e jashtme. Megjithatë, shqetësimi i madh qëndron në faktin se disa prej ambasadorëve kanë zhvilluar 3-4 mandate radhazi në postin e Ambasadorit, duke u zhvendosur nga një ambasadë në tjetrën. Kjo situatë është në kundërshtim të hapur me ligjin shqiptar dhe rregullat që e rregullojnë këtë fushë. Ky veprim tregon një shkelje të qartë të parimeve të nevojshme për një diplomaci të shëndetshme, duke e trajtuar postin e ambasadorit si një pozitë personale, e cila duhet të jetë në shërbim të interesave të vendit dhe qytetarëve të tij. Kjo ka pasoja negative, pasi krijon një ambient ku diplomatët përfitojnë nga pozitat e tyre, në vend që të angazhohen për zhvillimin e politikave dhe marrëdhënieve që janë në interesin kombëtar. Për më tepër, kjo sjellje e bën të vështirë për Shqipërinë të ndërtojë një diplomaci të qëndrueshme dhe të besueshme, duke dëmtuar reputacionin e saj ndërkombëtar. Në një botë ku ndihma diplomatike është thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe politik, është e domosdoshme që përfaqësuesit e vendit të ndjekin standarde të larta profesionale dhe etike. Shkeljet e tilla ndihmojnë vetëm në përkeqësimin e situatës dhe në pengimin e përparimit të vendit tonë në arenën ndërkombëtare.

### **Ambasadorë/Konsuj me Karrierë Politike**

Një numër prej 12 ambasadorësh dhe konsujsh (22.2%)<sup>33</sup> kanë patur një karrierë politike aktive.<sup>34</sup> Kjo tregon se politika shqiptare i shtrin ndikimet e saj në fusha të ndryshme, përfshirë edhe diplomacinë, e cila në thelb duhet të jetë krejtësisht e pavarur nga politika dhe të ketë një mision të qartë për të mbrojtur interesat kombëtare dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi me

<sup>32</sup> Tabela 2

<sup>33</sup> Tabela 2

<sup>34</sup> Gjatë vëzhgimeve tona për mbledhjen e të dhënave për studimin, vumë re se 6 prej ambasadorëve në detyrë vinin nga familje me pozita të rëndësishme politike ose kishin një anëtar të familjes me karrierë politike. Megjithatë, për arsye të limiteve të këtij studimi, nuk i përfshimë këto të dhëna.





shtete të tjera. Ndërhyrjet politike në këtë fushë dëmtojnë qëllimin e vërtetë të diplomacisë, e cila duhet të shkojë përtej interesave politike të brendshme dhe të fokusohet në përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Historikisht, diplomacia shqiptare në 30 vitet e fundit është karakterizuar nga emërimet të cilat shpesh janë bërë në bazë të interesave politike, duke përfshirë ish-deputetë, ministra, donatorë dhe mbështetës të partive në pushtet. Këto praktika ngrejnë shqetësime të mëdha rreth nepotizmit dhe mungesës së transparencës, duke krijuar mundësi për konflikte interesi. Përzgjedhja e ambasadorëve dhe konsujve në bazë të lidhjeve politike rrezikon të dobësojë efektivitetin e politikës së jashtme dhe të minojë besimin e partnerëve ndërkombëtarë në profesionalizmin e përfaqësuesve tanë.

Është thelbësore që diplomacia shqiptare të jetë e bazuar në profesionalizëm dhe meritokraci, një koncept që fatkeqësisht nuk ka qenë i përdorur gjerësisht në këtë fushë. Vetëm në këtë mënyrë Shqipëria mund të ruajë besimin dhe respektin e partnerëve ndërkombëtarë, si dhe të garantojë se përfaqësimi i saj në arenën globale do të jetë i pavarur nga interesat e ngushta politike.

### **Ambasadorë/Konsuj pa Status Diplomatik**

Një numër prej 18 ambasadorësh dhe konsujsh (33.3%)<sup>35</sup> janë emëruar pa pasur statusin e duhur diplomatik, gjë që tregon një shkëlqje të qartë të ligjit për politikën e jashtme të Shqipërisë. Ky ligj parashikon që përfaqësuesit e lartë diplomatik duhet të kenë statusin përkatës dhe vite përvojë në fushën e diplomacisë, në mënyrë që të përmbushin detyrat e tyre me profesionalizëm dhe efektivitet. Emërimi i këtyre përfaqësuesve pa përvojë dhe pa statusin e duhur ngre pikëpyetje serioze mbi cilësinë e përfaqësimit tonë në arenën ndërkombëtare.

Kjo situatë tregon se ambasadorët e emëruar, të cilët qëndrojnë për vite me radhë në krye të përfaqësive tona, nuk kanë kaluar përmes rrugës së zakonshme të diplomacisë, duke fituar grada dhe status në bazë të përvojës dhe kontributit të tyre në këtë fushë. Në vend që të përzgjedhin individë që kanë dhënë një kontribut të madh dhe kanë përvojë të gjatë diplomatike, emërimet shpesh bëhen në bazë të interesave të tjera, duke e dobësuar



<sup>35</sup> Tabela 2

seriozisht kapacitetin e Shqipërisë për të mbrojtur dhe promovuar interesat e saj në mënyrë të denjë dhe profesionale.

Mungesa e përvojës dhe statusit diplomatik të këtyre përfaqësuesve ndikon jo vetëm në cilësinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe në mënyrën se si Shqipëria perceptohet nga partnerët e saj. Respektimi i ligjit dhe përzgjedhja e përfaqësuesve në bazë të meritave është thelbësore për të garantuar një politikë të jashtme të qëndrueshme dhe të besueshme.

## 5. NDRYSHIMET LIGJORE TË REJA: KONTEKSTI DHE PASOJAT

Aktualisht, qeveria shqiptare ka nxjerrë për konsultim publik projektligjin e ri për politikën e jashtme.<sup>36</sup> Ky projektligj parashikon një ndryshim të rëndësishëm në mandatin e ambasadorëve, duke zgjeruar atë nga 3 në 4 vjet.<sup>37</sup> Ky ndryshim arsyetohet me pretendimin se periudha tre vjeçare nuk është e mjaftueshme për një ambasador për të ndërtuar kontakte dhe për të realizuar objektivat e tij diplomatikë.<sup>38</sup>

Megjithatë, analiza jone e deritanishme tregon se shumica e ambasadorëve nuk e kanë respektuar rregullin e mandatit trevjeçar, duke zgjatur në mënyrë të pafundme mandatet e tyre në mbi 10 vjet.<sup>39</sup> Ky fenomen ka çuar në dyshime për efektivitetin e politikës së jashtme shqiptare. Problemi kryesor nuk qëndron vetëm në numrin e viteve të mandatit, por në respektimin e afateve, si dhe nevojën për të alternuar midis përfaqësimit jashtë dhe rikthimit për të kontribuar në Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ).

Një nga pikat e këtij projektligji është Neni 32, pika 6, e cila përcakton se "Mandati i kreut të misionit diplomatik është katër vjeçar. Kreu i misionit diplomatik nuk mund të ushtrojë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshëm

<sup>36</sup>Konsultime Publike. (2024). *Projekti i ligjit për politikën e jashtme*.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/770>

<sup>37</sup> Top Channel. (2024, 19 gusht). *Zgjatet mandati i ambasadorëve: Ligji i ri nga 3 vjet shkon në 4, në emërimin e diplomatëve përfaqësues dhe Kuvendi*. Top Channel. <https://top-channel.tv/2024/08/19/zgjatet-mandati-i-ambasadoreve-ligji-i-ri-nga-3-vite-shkon-ne-4-ne-emerimin-e-diplomateve-perfshihet-dhe-kuvendi/>

<sup>38</sup> Ora News. (2024, 19 gusht). *Zgjatet mandati i diplomatëve, ndryshon ligji për ambasadorët dhe konsujt*. Ora News. <https://www.oranews.tv/politike/zgjatet-mandati-i-diplomatwve-ndryshon-ligji-per-ambasadoret-dhe-konsujt-i-1177853>

<sup>39</sup> Liberale. (2024, 5 tetor). *Ambasadorë me mandat 10-vjeçar: Shqipëria, një rast unik në botë. 41 titullarë të përfaqësive tona në shkelle të ligjit*. Liberale. <https://liberale.al/ekskluzive-ambasadore-me-mandat-10-vjecar-shqipëria-nje-rast-unikal-ne-bote-41-fitullare-te-perfaqesive-tona-ne-shkelje-te-ligjit-emrat>





në misionet diplomatike dhe poste konsullore." Formulimi aktual i kësaj pike duket i paqartë dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme. Duke pasur parasysh se formulimi aktual i pikës 6 të nenit 32 lë hapësira për interpretime, do të ishte e udhës që ky nen të riformulohej me më shumë detaje për të shmangur keqkuptimet.<sup>40</sup>

Një tjetër aspekt shqetësues është heqja e kriterëve kualifikues dhe skualifikues të karrierës në ligjin e ri. Kjo hap mundësinë që çdo individ të emërohet diplomat, çka rrezikon të përkeqësojë situatën duke rritur futjen e figurave politike në diplomaci. Një sistem i tillë mund të minojë profesionalizmin dhe efikasitetin e diplomacisë shqiptare.

Po ashtu, ky ligj duket se shfuqizon një rol të rëndësishëm të Parlamentit. Sipas formulimit të tij, komisioni parlamentar për politikën e jashtme do të zhvillojë seanca dëgjimore vetëm pas akreditimit të ambasadorëve, duke e bërë të vështirë mbikëqyrjen e procesit të emërimit dhe veprimtarisë së tyre.

Ky projektligj, në formën aktuale, legjitimon situatën aktuale dhe rrezikon të përkeqësojë të ardhmen e diplomacisë shqiptare. Prandaj, është thelbësore që ky ligj të rishikohet me kujdes për të siguruar një politikë të jashtme më të qëndrueshme dhe profesionale, e cila respekton procedurat dhe kontribuon në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare.



<sup>40</sup> MEPJ. (2024). *Projekti i ligjit për politikën e jashtme*. Tiranë.

## 6. GJETJET KRYESORE

Analiza e situatës së diplomacisë shqiptare tregon nevojën për një transformim të thellë në mënyrën si emërohen diplomatët shqiptarë. Shkeljet e ligjit, ndikimet politike dhe mungesa e përvojës diplomatike rrezikojnë efektivitetin e politikës së jashtme dhe reputacionin ndërkombëtar të vendit. Një sistem diplomatik i bazuar në meritat, profesionalizmin dhe transparencën është thelbësor për të forcuar besimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe për të siguruar që diplomacia të shërbejë si një mjet për përparimin e interesave kombëtare. Vetëm përmes ristrukturimit të procesit të emërimit dhe rritjes së standardeve, Shqipëria mund të ndihmojë në ndërtimin e një diplomacie të qëndrueshme dhe të besueshme.

Gjithashtu, projektligji i ri duket se legjitimon një situatë aktuale që ka rezultuar problematike, duke shfuqizuar rolin mbikëqyrës të Parlamentit mbi procesin e emërimit të diplomatëve. Kjo mund të çojë në një erozion të besimit të publikut në institucionet e diplomacisë dhe të ndikojë negativisht në përfaqësimin e vendit në skenën ndërkombëtare.

Përfundimisht, nevoja për një përmirësim më të qartë dhe më të saktë të ligjeve që rregullojnë diplomacinë shqiptare është evidente. Rishikimi i kriterëve të emërimit, rritja e transparencës në procesin e emërimit dhe garantimi i rotacionit të diplomatëve janë hapa të domosdoshëm për të forcuar dhe profesionalizuar diplomacinë shqiptare. Këto ndryshime do të kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi diplomatik më të fortë, më efikas dhe më të besueshëm, që do t'i shërbejë më mirë interesave të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.





## 7. REKOMANDIME

Kufizimi i mandateve dhe zbatimi rigoroz i ligjit: Është e domosdoshme të vendoset një sistem monitorimi i rreptë për respektimin e kufirit të mandateve diplomatike. Përfaqësuesit duhet të respektojnë rregullin e mandatit 3-vjeçar, dhe çdo zgjatje duhet të bëhet vetëm me justifikime të qarta dhe të bazuara në nevojat kombëtare.

Reduktimi i përfshirjes politike dhe nepotizmit: Ligji duhet të rishikohet për të minimizuar emërimet jashtë sistemit të diplomacisë. Duhet të vendosen kriteret e qarta për kualifikimet e individëve që do të emërohen në pozicione diplomatike, duke siguruar që vetëm individë me përvojë dhe ekspertizë të përfshirën.

Konsolidimi i rolit të Presidentit dhe Komisionit të Politikës së Jashtme: Duke i kthyer kompetencat Presidentit dhe Komisionit të Politikës së Jashtme për procesin e emërimit dhe shkarkimit të ambasadorëve, mund të krijohet një balancë më e madhe midis pushteteve dhe të sigurohet një proces më transparent dhe i mbështetur në meritokraci.

Forcimi i kriterit të statusit diplomatik: Të gjithë përfaqësuesit shqiptarë duhet të kenë statusin e diplomatit, në përputhje me ligjin, për të siguruar që Shqipëria të përfaqësohet me dinjitet dhe profesionalizëm në arenën ndërkombëtare.



## 8. REFERENCA

Konsultime Publike. (2024). *Projekti i ligjit për politikën e jashtme*. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/770>

Liberale. (2024, 5 tetor). *Ambasadorë me mandat 10-vjeçar: Shqipëria, një rast unik në botë. 41 titullarë të përfaqësive tona në shkelje të ligjit*. Liberale. <https://liberale.al/ekskluzive-ambasadore-me-mandat-10-vjecar-shqiperia-nje-rast-unikal-ne-bote-41-titullare-te-perfaqesive-tona-ne-shkelje-te-ligjit-emrat>

MEPJ. (2024). *Projekti i ligjit për politikën e jashtme*. Tiranë.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. (n.d.). *Përfaqësitë shqiptare në botë*. <https://punetejashtme.gov.al/perfaqesite-shqiptare-ne-bote/>

Ora News. (2024, 19 gusht). *Zgjatet mandati i diplomatëve, ndryshon ligji për ambasadorët dhe konsuj*. Ora News. <https://www.oranews.tv/politike/zgjatet-mandati-i-diplomatwve-ndryshon-ligji-per-ambasadoret-dhe-konsuj-i-1177853>

Qeveria e Shqipërisë. (2015). *Ligji Nr. 23/2015 për shërbimin e jashtëm*. Tiranë

Shqiptarja.com. (2024). *Besart Kadia emërohet ambasador në Azerbajxhan, Tonin Gjurarj në Kroaci, Artemis Malo në Kanada*. <https://shqiptarja.com/lajm/besart-kadia-emerohet-ambasador-ne-azerbajxhan-tonin-gjuraj-ne-kroaci-artemis-malo-ne-kanada>

Telegraf. (2024, 5 tetor). *Ministria e jashtme dhe ambasadat të mbushura me miq dhe krushq*. Telegraf. <https://telegraf.al/politike/ministria-e-jashtme-dhe-ambasadat-te-mbushura-me-miq-dhe-krushq/>

Top Channel. (2024, 19 gusht). *Zgjatet mandati i ambasadorëve: Ligji i ri nga 3 vjet shkon në 4, në emërimin e diplomatëve përfshihet dhe Kuvendi*. Top Channel. <https://top-channel.tv/2024/08/19/zgjatet-mandati-i-ambasadoreve-ligji-i-ri-nga-3-vite-shkon-ne-4-ne-emerimin-e-diplomateve-perfshihet-dhe-kuvendi/>





#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)